Të gjitha punimet e instalimit duhet të bëhen sipas kërkesave për kompletimin e një pune me cilësi të lartë

Një shembull i bravës që do të përdoret duhet ti jepet për shqyrtim Supervisorit për aprovim paraprak para fiksimit.

6.3.10 Menteshat

Furnizimi dhe fiksimi i menteshave të bëra me material çeliku inoks ose të veshur me shtresë bronxi, sipas përshkrimeve të dhëna në Vizatimet Teknike, do të bëhet sipas

standartit dhe cilësisë. Materiali i çelikut duhet të sigurojë qëndrueshmërinë e lartë të menteshave, mos thyeshmërinë e tyre ndaj goditjeve mekanike, elasticitetin e duhur të menteshave, jetëgjatësinë prej 180 000 cikle jete gjatë punës, etj.

Menteshat duhet të jenë të përbëra prej:

- Kunji prej çeliku të veshur me shtresë bronxi, me fileto, tip mashkull;
- Kunji prej çeliku të veshur me shtresë bronxi, tip femër;
- Katër vidat e çelikut që përdoren për mberthimin e tyre në objekt.

Forma dhe përmasat e pjesëve përbërëse jepen në Vizatimet teknike.

Të dy kunjat e mësipërm duhet të levizin lirshëm tek njëri tjetri duke bërë të mundur një lëvizje sa më të lehtë të kornizës së derës ose të dritares kundrejt kasës së tyre. Gjatë montimit si dhe gjatë shfrytëzimit këto kunja mund të lyhen me vaj për të eliminuar zhurmat që mund të bëhen gjatë punës së tyre.

Menteshat që përdoren për dyert përbëhen prej dy kunjave të mësipërm dhe 4 vidave metalike për mberthimin e tyre. Kunjat me fileto tip mashkull duhet të jenë me diametër $d=14-16$ mm. Gjatësia e kunjit tip mashkull është $L_1 = 60$ mm kurse gjatësia e filetosit të tij duhet të jetë të paktën $L_2 = 40$ mm. Ky kunj filetohet në kornizën e derës sipas përshkrimit të dhënë në Vizatimet Teknike. Koka e kunjit duhet të jetë në formën e kokës të gurit të shahut. Kunji metalik tip femër mbërthehet me anë të katër vidave metalike në pjesën tjetër të derës. Menteshat e poshtme që vendosen në derë duhet të jetë jo më shumë se 25 cm mbi pjesën e poshtme të kornizës së derës.

Menteshat që përdoren për dritaret përbëhen prej dy kunjave të mësipërm dhe 4 vidave metalike për mberthimin e tyre. Kunjat me fileto tip mashkull duhet të jenë me diametër $d=12-13$ mm. Gjatësia e kunjit tip mashkull duhet të jetë $L_1 = 50$ mm kurse gjatësia e filetosit të tij duhet të jetë të paktën $L_2 = 30$ mm. Koka e kunjit duhet të jetë në formë të rrumbullakët. Ky kunj filetohet në kornizën e dritares sipas përshkrimit të dhënë në Vizatimet Teknike. Kunji metalik tip femër mbërthehet me anë të katër vidave metalike në pjesën tjetër të dritares. Menteshat e poshtme që vendoset në dritare duhet të jetë jo më shumë se 15 cm mbi pjesën e poshtme të kornizës së dritares.

Gjatë montimit të dyerve duhet të vendosen të paktën 3 mentesha në tre pika ankorimi në largësi minimale prej njëra tjetrës $L_{min} = 50$ cm dhe për dritaret 2 mentesha në largësi minimale prej njëra tjetrës me $L'_{min} = 30$ cm. Lloji i

menteshave që do të vendosen janë të përcaktuara në projekt. Ato janë në varësi të llojit dhe madhësisë së dyerve dhe dritareve.

Të gjitha punët e lidhura me instalimin dhe vendosjen e tyre në objekt duhet të bëhen sipas kërkesave teknike të supervisorit dhe të projektit. Një model i menteshës, së bashku me çertifikatën e cilësisë dhe të origjinës së mallit, duhet të jepet për shqyrtim supervisorit për aprovim para se të vendoset në objekt.

6.3.11 Dorezat

Të përgjithshme

Dorezat e dyerve / dritareve duhet të jenë të njëjta në të gjitha ambientet e qëndrës sociale. Në mënyrë që të plotësohet ky kusht duhet që këto doreza të jenë të tilla, që mund të përdoren si në ambientet e thata ashtu edhe në ato me lagështirë.

Kriteret që duhet të plotësojnë

Dorezat e dyerve dhe të dritareve duhet të jenë:

- a) **Të kenë shkallë të lartë sigurie në përdorim (jetëgjatësi gjatë përdorimit të shpeshtë);**


Jetëgjatësia e dorezave varet kryesisht nga materialet me të cilat janë prodhuar ato, si dhe nga mënyra e lidhjes së dorezës me elementët e tjerë (cilindrit, bravës etj.)

Për këtë sugjerohet që të zgjidhen doreza, të cilat janë prodhuar me material të fortë dhe rezistentë psh. Çelik jo i ndryshkshëm

- b) **Të garantojnë rezietencë momentale ndaj ngarkesave (të sigurojë qëndrueshmëri në rastet e keqpërdorimit: varjet, goditjet, përplasjet etj);**

Duke patur parasysh përdoruesit e këtyre dorezave, duhet që ato të kenë koeficientë të lartë qëndrueshmërie në ngarkesë, pra duhet ti rezistojnë peshës së fëmijëve tek doreza.

Sipas normave Evropiane (DIN) ekzistojnë dy klasa qëndrueshmërie. Tabela e mëposhtme paraqet ngarkesat për këto dy klasa nga të cilat për rastin tonë do të sugjerohet klasën ES2.

Veçorite	Kerkesat		
	ES1	ES2	
Ngarkesa ne qender	25 kN	40 kN	
Ngarkesa ne Cilinder	15 kN	17 kN	
Ngarkesa e njeanshme	15 kN	20 kN	

- c) Të mos shkaktojnë dëmtime fizike gjatë përdorimit.

Montimi

Përpara se të bëhet montimi i dorezave ato duhet ti tregohen supervizorit dhe vetëm pas miratimit të tij të bëhet montimi.

Montimi i dorezave duhet të bëhet i tillë që të plotësojë kriteret e lartpërmendura.

Në montimin e dorezës duhet të zbatohen me korrektësi të plotë udhëzimet e dhëna nga ana e prodhuesit të saj.

SEKSION 7

Sistemi i mbrojtjes atmosferike

Sistemi i mbrojtjes atmosferike është shumë i domosdoshëm, për vetë kushtet atmosferike dhe vendodhjen gjeografike të Godinave Shëndetësore. Sistemi i mbrojtjes atmosferike është dhe duhet të ndërtohet i pavarur, nga ai i sistemit të tokëzimit të mbrojtjes. Ky sistem duhet të plotësojë kushtet e zbatimit sipas KTZ në Shqipëri. Vlera e rezistencës së tokëzimit të këtij sistemi duhet të jetë më e vogël se 4Ω . Gjatë punës për këtë sistem, pasi të jenë vendosur elektrodën dhe ndërtuar konturi i tokëzimit,

kryhen matje të rezistencës. Në rast se rezistenca e tokëzimit është më e madhe se 4Ω , atëherë duhet rritur numri i elektrodave derisa të arrihet kjo vlerë. Matjet duhen përsëritur dy herë. Një herë në tokë me lagështirë dhe një herë me tokë të thatë. Materialet që do të përdoren për këtë sistem, shiriti zinkato e elektrodën që futen në tokë, shigjetat, aksesorët me buloneri fiksuese, duhet të jenë të gjitha të zinkuar. Shiriti zinkato duhet të jenë me përmasa 30x3mm. Shufra zinkato duhet të jetë me diametër 8mm. Elektrodën duhet të jenë me gjatësi 1.5m me dimensione 50x50x5mm të zinkuara të prodhuara nga fabrika. Shigjeta/Shtiza duhet të jetë material zingato me majë dhe me gjatësi të tillë që të dalë minimumi 0.5 m mbi pikat më të larta të objektit. Bulonat dhe dadot që do të përdoren për fiksime të shiritit me elektrodën duhet të jenë minimumi M-12.

Ndërtimi i tokëzimit të realizohet sipas radhës së punimeve:

- Të hapet një kanal me thellësi min. 0.5 m me gjerësi të mjaftueshme sa për të shtrirë shiritin e tokëzimit, në të gjithë perimetrin e objektit, rreth 1m larg tij, mundësisht në trotuar ose afër trotuarit të ndërtesës.
- Shtrirja e shiritit në të gjithë perimetrin e tij.
- Montimi i elektrodave 1.5 m në thellësinë 2 m, nga niveli i trotuarit të ndërtesës ose afër trotuarit, në pikat e përcaktuara në planimetrinë përkatëse të projektit dhe lidhja e tyre me shiritin e tokëzimit dhe me zbritësat e konturit të rrufepritësit.
- Dalja nga elektrodën me shirit, sipas pikave të përcaktuara në fletën e projektit, deri në soletë duke e fiksuar shufrën zinkato në tub plastik, në mur në kanal elektrik vertikal, ose me aksesorë përkatës me anë të vidave me upa plastike.
- Daljet në taracë lidhen me njëra tjetrën, të vendosura mbi kubike betoni të tipit 393TB me dimensione 115x95x60 mm duke formuar konturin e mbyllur të rrufepritësit me anë të të njëjtit shirit zinkato.
- Në pikën-at më të larta të taracës së ndërtesës, fiksohen shtizat e rrufepritësit me gjatësi 100 cm, të lidhur me konturin e rrufepritësit, me aksesorë përkatës. Të gjitha lidhjet duhet të bëhen me buloneri për të arritur përcjellshmëri të lartë dhe për të eliminuar fenomenin e korrozionit dhe oksidim në pikat e lidhjeve

SEKSION 8

Sistemi Ngrohje-Ftohje

Përsa i përket sistemit të ngrohje-ftohjes, duke u nisur nga kërkesat e Autoritetit Kontraktor si edhe nga gjendja ekzistuese është menduar që ky sistem të realizohet me paisje individuale për çdo dhomë. Theksojmë se instalimet elektrike për këtë sistem janë të kryera dhe njësia/kondicioneri do të vendoset në atë pozicion që e dikton pikërisht lidhja e fuqisë pra e prizës përkatëse. Pasi janë bërë llogaritjet në bazë të volumit të çdo ambjenti

respektivë rezulton se kondicionerët do të jenë 2 llojesh me kapacitet 9000 BTU si edhe 12000 BTU.

Paisjet duhet të jenë të paisura me Çertifikatat dhe deklaratat përkatëse nga prodhuesi si edhe duhet të kenë markimin CE. Kontraktori përpara porosisë duhet të marri miratimin me shkrim nga Mbikqyrësi si edhe nga përfaqesues të Investitorit.

Specifikimi i Materialeve:

RAPORT TEKNIK

PROJEKT ZBATIM

HARTOI: DRICONS SHPK

**OBJEKTI: STUDIM PROJEKTIMI "RIKONSTRUKSION I PJESSHËM I PAVIONIT TË
PATOLOGJISË SË BARRËS NË MATERNITETIN MBRETËRESHA GERALDINE"**

TIRANË

POZICIONI GJEOGRAFIK I ZONËS 1



Fig. 1 - Pozicioni gjeografik, Bulevardi Zogui I-re, Tirane

GJENDJA EKZISTUES

Gjendja ekzistuese e Pavionit të Patologjisë së Barrës në Maternitetin Mbretëresha Geraldine është pjesërisht e mirë. Kjo përfaktin duke ju referuar edhe mirëmbajtjes që kryen Autoriteti Kontraktor. Pas vizitës në objekt u vërejt se duhet të kryhen disa ndërhyrje të pjesshme në mënyrë që pavionit të sigurojë dhjetë përmirësime kushtet e nevojshme për pacientët. Më konkretisht duam të theksojmë se në Katin e III-të os të fundit të pavionit vërehen shenja të lagështies në shtetë dhe në muraturë. Kjo vjen për faktin se hidroizolimi ekzistues i taracës së shtetit dhe parapeti me kapuç beton janë të jetë amortizuara. Gjithashtu edhe vlerat ekzistuese janë të ngushta dhe të amortizuara. Dritaret janë dritare duro-alumini të këqija. Duam të theksojmë se dhomat e pacientëve nuk kanë ngrohje. Siedhe objektin nuk ka mbrojtje atmosferike. Gjendja ekzistuese e tualetëve, instalimeve dhe hardsiellave të shtetit dhe elektrike është në gjendje të mirë dhe optimale. Më poshtë paraqitet disa foto të gjendjes ekzistuese.



Fragment fotografikigjendjesekzistuese

NDËRHYRJET QË DO TË KRYHEN

Ndërhryrjet që do të kryhen bazohet në kërkesat e Autoritetit Kontraktors dhe nga studiimi gjendjes faktike të objektit të Pavionit të Patologjisë së Barrës në Maternitetin Mbretëresha Geraldine.

Ndërhryrjet që do të kryhen në katin e III-të konsistojnë në proceset e mëposhtme :

I- Punime Prishje

Në këtë kapitull përfshihen punimet për prishjen e shtresave të taracës, prishja e kapakut b/a të parapetit të taracës, çmontimi i dyerve dhe dritareve ekzistuese si dhe transporti dhe depozitimi i materialeve në landfill.

II- Punime Hekur Betoni

III- Punime Beton dhe Beton-Arme

Në këtë kapitull është parashikuar ndërtimi i brezit beton-arme në kokë të parapetit të taracës ekzistuese, në mënyrë që të bëhet rigjizimi i parapetit dhe fiksimi i kapuçit.

IV- Punime Dyer Dritare

Në këtë kapitull janë parashikuar të ndërron të gjitha dyert ekzistuese me përjashtim të dyerve të tualetëve si dhe dyerve duro-aluminit të korridoreve lidhës. Kjo për faktin se janë të jetta amortizuar si dhe do të zgjerohen me gjerësi nga 90cm në 120 cm hapësirë dritë në mënyrë që të aksesohen lehtësisht nga pacientët me barrela. Dritaret do të realizohen me material plastik PVC si dhe dopioxham, me përjashtim të dritareve që ndodhen në faqet e

objektit kalifikansiedhetë ambjente vetëkuzhinës dhe hollit përballë ashensorit që do jenë këto ekzistuese, në mënyrë që të rritet dhe aftësi termike e ambjenteve për pacientët. Theksojmë se dyert dhe dritaret janë parashikuar furnizim dhe vendosje. Përpara se të vendosendyert duke marrë në konsideratë zgjerimin e tyre, në fillim do të realizohet hapja e shpatullave duke prishur murin e tullës dhe ndërtime arkitrare vetërinj b/angavëtë Autoriteti Kontraktor me grupet e mirëmbajtjes, sipas kërkesës së këtij të fundit.

V- Punime Taracë

Në këtë kapitull janë parashikuar të gjitha punimet e taracës me shtresat dhe n/shtresat përkatëse në mënyrë që të sigurohet hidroizolimi, poashtu edhe termoizolimi. Të gjitha detajet e këtyre zërave të punimeve paraqiten në projektin dhe specifikimet teknike përkatëse.

VI- Punimet e Mbrojtjes Atmosferike

Në këtë kapitull janë parashikuar të gjitha punimet e mbrojtjes atmosferike duke u nisur nga fakti që objektin nuk ka pasur një sistem të tillë. Mbrojtja atmosferike do të realizohet me sistemin e rrjetit të përcjellës të shiritit të zinkut, i cili do të shkarkojnë tokë sinje sistemin i mbyllur në elektrodat e tokëzimit.

VII- Punimet e Ngrohjes

Në këtë kapitull është parashikuar që të realizohet ngrohja dhe ftohja e dhomave të pacientëve me njësi individuale /kondicioner duke marrë në konsideratë edhe kapacitetin në volum të ambjenteve. Theksojmë se instalimet elektrike për këtë punim janë të realizuar edhe më jafton vetëm furnizim dhe vendosja e kondicionerëve.

AFATI I REALIZIMIT TË PUNIMEVE

Afati i realizimit të Punimeve do të jetë 20 ditë, nga data e lidhjes së kontratës së shoqërisë Sipërmarrëse me Autoritetin Kontraktor, sipas grafikut të punimeve.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Sipas projektit të zbatimit bashkelidhur

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/ Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/ kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

GRAFIKUT I ZBATIMIT TË PUNIMEVE

Afatet e realizimit të punimeve:

GRAFIK PUNIMESH

OBJEKTI: RIKONSTRUKSION I PJESSHEM I PAVIONIT TE PATOLOGJISE SE BARRES NE MATERNITETIN MBRETERESHA GERALDINE

Adresa: Rruga" Bulevardi Zogu I I-re"

AFATI DO TE JETE 20 DITE KALENDARIKE

NR	PERSHKRIMI I PUNIMEVE	5 Dit.I	5 Dit.II	5 Dit.III	5 Dit.IV
1	NGRITJE KANTIERI				
2	PUNIME PRISHJE				
3	PUNIME HEKUR BETONI				
4	PUNIME BETONI E BETON-ARME				
5	PUNIME DYER DRITARE				
6	PUNIME TARACE				
7	PUNIME TE MBROJTJES ATMOSFERIKE				
8	PUNIME NGROHJE-FTOHJE				

Shënim. Autoriteti/ kontraktor mund të shtojë rreshta në varësi të zërave të punimeve dhe kollona në varësi të afatit të parashikuar për realizimin e tyre.

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënua për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënua ose nuk ka qenë i dënua nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënua me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërket për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojces 8.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkëpunim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës8,
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Operatori ekonomik duhet të ketë burime financiare të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit dhe merr përsipër çdo rrezik që mund të ndodhë, siç parashikohet apo nënkuptohet në kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës. Në këtë kontekst, operatorët ekonomikë duhet të tregojnë se i përmbushin kushtet e mëposhtme:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet (jo më e vogël se vlera e fondit limit).**

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 29 % e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit² që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

²Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

2.3.2. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës ose lotit që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

2.3.3 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9;
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit; **(në rastet kur ky dokumentacion lëshohet)**
 - Certifikatën e marrjes në dorëzim/Certifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim.
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - vërtetim lëshuar nga subjekti privat shoqëruar me:
 - Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit; **(në rastet kur ky dokumentacion lëshohet)**
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9;
 - Fatura tatimore të situacionit përfundimtar
- c) Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kontratën e bashkimit të operatoreve dhe prokurën e posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit.
- ç) Për kontratat e realizuara si Nenkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:
 - a) Kontratë baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe
 - b) Miratimin zyrtar si nenkontraktor nga ana e Autoritetit Kontraktor.

2.3.4 Licenca profesionale të operatorit për realizimin e objekti të kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;

Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- NP-2 A (Ndërtim Civile dhe Industriale)
 - NP-3 A (Rikonstrukcion dhe Mirëmbajtje Godinash civile dhe Industriale, Veshje Fasada)
 - NS -1 A (Punime për Prishjen e Ndërtimeve)
 - NS-4A (Punime Rifiniture te Muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture te natyrës teknike ndërtuese)
 - NS-12 A (Impiant teknologjik, termik dhe te kondicionimit)
 - NS-14 A (Impiante te brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj)
- sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqes një dëshmi nga administrata tatimore për punësimin mesatar jo më pak se 10 punonjës për periudhën Nëntor 2021-Prill 2022 shoqëruar me Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhën e kërkuar.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor drejtues teknik, si më poshtë:

- Arkitekt 1 (një)
- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier Mekanik 1 (një)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinier/Arkitekt ekspert për eficientë energjisë 1 (një)

Eksperti për eficientë e energjisë duhet të jetë i pajisur me certificate për Auditimin e Energjisë në Ndërtesa, certifikatë e lëshuar nga organe të certifikuara/licencuara. (te paraqes certifikat te vlefshme);

Punonjësit e mësipërm duhet jene te pasqyruar në Licencën e Shoqërisë dhe ne Listë pagesat e periudhës Nëntor 2021- Prill 2022. *Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë: **Kontratë pune të vlefshme, Diplomë.***

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet te ketë te paktën:

- a) Operatori ekonomik te ketë ne stafin e tij si drejtues teknik 1 (një) inxhinier/arkitekt specialist Ekspert Zjarrfikës ne fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, ne mbështetje te pikës 4 te nenit 49 te Ligjit Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", te figurojnë ne listë pagesat e shoqërisë për periudhën Nëntor 2021-Prill 2022. Detyrimisht te paraqitet kontrate pune dhe certifikata përkatëse e dhënë nga Drejtoria e MZSH
- b) Eksperti për menaxhimin e energjisë duhet të jetë i pajisur me certificate për Menaxhimin e Energjisë, certifikatë e lëshuara nga organe të certifikuara/licencuara . (te paraqes certifikat te vlefshme);
- c) Te ketë në listepagesë mjekun e shoqërisë e periudhës Nëntor 2021- Prill 2022, për të cilin duhet paraqitur, kontrate pune, diplomë, licencë.
- ç) Te ketë në listepagesë nje Ekspert mjedisi te pajisur me certifikaten e Vlerësimin e Ndikimit ne Mjedis (VNM) e periudhës Nëntor 2021- Prill 2022.
- d) Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklarate të Administratorit të shoqërisë Drejtuesin/(t) Teknik të punimeve në objekt do të jetë/jenë i/ të pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, i cili/të cilët të kenë eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet dhe të jetë i pajisur me Diplomë, Kontratë pune, Librezë pune.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO te lëshuara nga organizmat e vlerësimit te konformitetit te cilat janë te akredituara nga

DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues te njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015(ose ekuivalente) (e vlefshme).
- b) Çertifikatën e menaxhimit Mjedisor ISO 14001:2015(ose ekuivalente)(e vlefshme).

2.3.9 Ofertuesi duhet të disponojë këto makineri:

Nr	Emri i mjetit	Njësi	Sasi	Statusi
1	Kamionë vetëshkarkues min 8 Ton	Copë	1	Në pronësi ose me qira
2	Kamionçine me kapacitet mbajtës 3-7.5 ton	Copë	1	Në pronësi ose me qira
3	Kamionçine me kapacitet mbajtës 1-3 ton	Copë	1	Në pronësi ose me qira
4	Kamion me vinç	Copë	1	Në pronësi ose me qira
5	Gjenerator	Copë	1	Në pronësi ose me qira
6	Pompa Uji	Copë	2	Në pronësi ose me qira
7	Depozitë Uji (mbi 5.000 Litra)	Copë	2	Në pronësi ose me qira
8	Betoniere mbi 500 litra	Copë	1	Në pronësi ose me qira
9	Vinç karel (portativ) i lëvizshëm me kapacitet 0.3 ÷ 0.5 ton:	Copë	2	Në pronësi ose me qira
10	Kamion me kosh me lartësi te paktën 10 m	Copë	1	Në pronësi ose me qira
11	Vibrator	Copë	2	Në pronësi ose me qira
12	Matrapik	Copë	2	Në pronësi ose me qira
13	Skele	M2	100	Në pronësi ose me qira
14	Shkallë	Copë	1	Në pronësi ose me qira
15	Karroçë pune	Copë	10	Në pronësi ose me qira
16	Prozhektor	Copë	1	Në pronësi ose me qira
17	Aparat saldimi	Copë	1	Në pronësi ose me qira

Operatori ekonomik duhet të disponojë mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 10 (dhjete) copë
- Jelekë minimumi 10 (dhjete) copë
- Fikse zjarri të lëvizshme minimumi 4 (katër) copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 4 (dhjetë) copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 20 (Njëzetë) copë
- Karroca dore minimumi 5 (shtate) copë
- Rrip sigurimi (10) copë

Makineritë dhe pajisjet në pronësi të shoqërohen me akt pronësie origjinal ose fotokopje e noterizuar.

- a) Makineritë dhe pajisjet me qira të shoqërohen me kontrata qiraje të lidhura para noterit publik, si dhe të shoqërohen me aktin e pronësisë të qiradhënësit (origjinal ose fotokopje e noterizuar).
- b) Kohëzgjatja e kontratave të qerasë për makineritë/pajisjet në fjalë duhet të mbulojë të gjithë kohën e parashikuar në Grafikun e Punimeve për përfundimin e zbatimit të punimeve.
- c) Për mjetet që shënohen në regjistrat publik duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin (Certifikatat pronësie, leje qarkullimi, akt kolaudimi, siguracion, leje transporti). Për pajisjet e tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat e blerjes, origjinalë ose fotokopje e noterizuar. Të gjitha mjetet dhe pajisjet e kërkuara të jenë të shoqëruara me foto.

2.3.10 Në përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit përkatës të publikuar ne SPE, operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/kontratë bashkëpunimi nga

prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë si më poshtë:

- a) Certifikatë për bojërat Ekologjike me ISO 9001:2015 të prodhuesit;
- b) Certifikatë për xhamat/vetratat e dritareve me ISO 9001:2015 të prodhuesit;

Në rast paraqitjeje të autorizimit nga Distributori duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit të autorizuar.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 8.*(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)***FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____

deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik****(nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Punët/ pajisjet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

--	--	--	--

• **Informacion mbi subjektet, mbi kapacitetin e, të cilave do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentacit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni]

data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.	Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]

B: DEKLARATA Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

--

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:	_____
1. Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklarate;	Po []
2. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet;	Po []
3. Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të paraqitur një Ofertë në emër të Ofertuesit;	Po []
4. Çdo person, nënshkrimi i të cilit paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në emër të ofertuesit;	Po []
5. Për efekt të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë e kuptoj se fjala "konkurrent" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, përveç Ofertuesit, pavarësisht nëse paraqitet si një bashkim i operatorëve ekonomikë ose jo, që: a) paraqet një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është ofertues i mundshëm i cili, bazuar në kualifikimet, aftësitë ose përvojat e tij, mund të paraqesë një Ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës .	Po []
6. Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër;	Po [] Jo []
7. Ofertuesi deklaron se është konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet e bashkangjitura, detajet e kësaj oferte përfshijnë emrat e konkurrentëve, natyrën dhe arsyet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes ose angazhimit (në rast të një bashkimi të operatorëve ekonomikë ose nën-kontraktimit).	Po [] Jo []
8. Në veçanti, pa cenuar pikat 6 dhe 7 më lart, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, kontratë ose marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me :	Po [] Jo []

a) çmimet; b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit; c) qëllimin ose vendimin për të paraqitur një ofertë ose jo; ose d) paraqitjen e një oferte që nuk plotëson specifikimet e kërkesës së ofertës.	
9. Për më tepër, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, marrëveshje ose kontratë me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet ose kërkesat specifike të punëve shërbimeve/apo pajisjeve në lidhje me prokurimin përkatës, përveç kur thuhet në pikën 7 më lart.	Po [] Jo []
10. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të ditura ose treguar ofertuesve të tjerë në asnjë mënyrë, qoftë para datës dhe orës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes së ofertës fituese dhe nënshkrimit të kontratës, përveç nëse kërkohet nga ligji ose nëse thuhet specifikisht nën pikën 7 më lart.	Po [] Jo []

C: DEKLARATAMBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon: Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike. Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë: - Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil. Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky

ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2022 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se:	
1. Operatori ekonomik garanton mbrojtjen e së drejtës për punësim dhe profesion nga çdo formë e diskriminimit parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.	Po [] Jo []
2. Operatori ekonomik ka kontratat përkatëse të punës me punonjësit e tij dhe garanton masa sigurie dhe shëndetësore për të gjithë dhe, në veçanti, për grupet në nevojë, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.	Po [] Jo []
3. Operatori ekonomik nuk ka ndonjë masë efektive ligjore të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale (ISHPSHSH). Në rastet kur janë identifikuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.	Po [] Jo []

Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË “Per permbushjen e specifikimeve teknike dhe grafikut e realizimit të objektit të kontratës”

Deklarata	Përgjigje
